



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 02  
Datë: 05/01/2022

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në vazhdimin e mbledhjes të datës 09.12.2021, të mbajtur me datë 15.12.2021, vendosi që të publikoj:

### NJOFTIM

*Për aplikim të studentëve kosovar që janë fëmijë të një prindi për lirim nga pagesa e semestrave të vitit akademik 2021/22*

1. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në Universitetin e Prishtinës do të paguajnë vetëm për njërin prej tyre me kusht që të plotësohen kushtet e poshtëshënuara, ndërsa për studentët tjerë nuk do të paguajnë.
2. Të drejtë lirimi nga pagesa kanë studentët e rregullt dhe me korrespondencë në nivelin e studimeve baçelor si dhe studentët në nivelin e studimeve master.
3. Në qoftë se në UP studiojnë më shumë se 2 anëtarë të një familje të ngushtë (fëmijë të një prindi) lirimi do të bëhet sipas këtij prioriteti:
  - a) Studentët me status të rregullt në nivelin baçelor në raport me studentin që ka status me korrespondencë në nivelin baçelor dhe me studentin e nivelit master;
  - b) Studentët që kanë statusin e studentit me korrespondencë në nivelin baçelor në raport me studentin e nivelit master;
  - c) Studenti i nivelit master mund të lirohet vetëm nëse nuk ka studentë që i takojnë dy prioriteteve paraprake
4. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
  - a) Certifikata e lindjes për secilin prej studentëve të familjes së ngushtë;
  - b) Certifikata e bashkësisë familjare;
  - c) Kopja e letërnjoftimit të studentit/es;
  - d) Vërtetimi për statusin e studentit, dhe dëshminë për regjistrim të vitit akademik aktual, (secili student veç e veç);
  - e) Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje (pa i caktuar studentit prioritetet), numrin kontaktues dhe e-mail adresën e secilit studentë.

5. Dokumentacioni i kompletuar për lirim nga pagesa në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje dorëzohen në zyrën e shërbimit të studentëve në ndërtesën e Bibliotekës Qendrore të Universitetit, ndërsa komisioni vendos se cili prej studentëve do të lirohen nga pagesa.
6. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni për lirim.
7. Studentët të cilët lirohen nga pagesa do të informohen përmes fakultetit përkatës dhe ueb-faqes elektronike të UP-së [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu).
8. Aplikimi do të jetë i hapur 15 ditë kalendarike, respektivisht prej datës **05.01.2022** deri me datë **20.01.2022 në orën 15:30**.
9. Ditën e parë, me datë **05.01.2022**, aplikimi elektronik do të funksionalizohet nga ora 13:00.
10. Studentët të cilët lirohen nga pagesa duhet të parashtrijnë kërkesë në platformën elektronike SEMS, në linkun: [studenti.uni-pr.edu](http://studenti.uni-pr.edu), për rimbursim të mjeteve të cilat i kanë paguar për regjistrim të semestrave përkatës të vitit akademik 2021/22. Me rastin e parashtrimit të kërkesës duhet bashkëlidhur dokumentet si në vijim:
  - a) Fletëpagesën e semestrit;
  - b) Kopjen e kartelës së bankës (numri i xhirollogarisë duhet të jetë i qartë).
11. Ky njoftim vlen për vitin akademik 2021/22.

**Këshillë juridike:** Studentët e pakënaqur me vendim të komisionit për lirim nga pagesa, mund të bëjnë ankesë pranë të njëjtit komision, në ndërtesën e rektoratit në afat prej 48 orësh pas publikimit të vendimit për lirim nga pagesa.

